



Numri i lëndës: KSC-BC-2023-12

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt,
Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marzhori Masëlo

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 3 tetor 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendimi i Pestë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt

Prokurores së Specializuar
Kimbërl P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Sofi Menegon
Luka Mishetiq

Mbrojtjes së Bashkim Smakajt
Xhonatan Ris
Hju Bauden

Mbrojtjes së Isni Kilajt
Ian Eduards
Xho Holms

Mbrojtjes së Fadil Fazliut
David Jang

Mbrojtjes së Hajredin Kuçit
Aleksandër Admiral

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 41(6), (10) dhe (12) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 56(2) dhe 57(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Bashkim Smakaj ("z. Smakaj") u arrestua në Kosovë², në bazë të një vendimi dhe fletarrestimi të lëshuar nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake³, dhe në vijim të konfirmimit të aktakuzës kundër tij, Hashim Thaçit ("z. Thaçi"), Fadil Fazliut, Isni Kilajt dhe Hajredin Kuçit ("Vendimi i Konfirmimit")⁴
2. Më 8 dhjetor 2024, në paraqitjen e parë të z. Smakaj, Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të tij.⁵

¹ KSC-BC-2023-12, F00015, Kryetarja, [Decision Assigning a Pre-Trial Judge](#) (Vendim për Caktimin e Gjykatëses së Procedurës Paraprake), 6 qershor 2024, publik.

² KSC-BC-2023-12, F00042, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Bashkim Smakajt sipas Rregullës 55(4)*, 5 dhjetor 2024, publik.

³ KSC-BC-2023-12, F00037, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Çështje Përkatëse* ("Vendimi për Arrestimin"), 29 nëntor 2024, konfidencial, me shtojcat 1-8, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik i vendimit u lëshua më 19 dhjetor 2024, [F00037/RED](#).

⁴ KSC-BC-2023-12, F00036, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 29 nëntor 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua 12 shkurt 2025, [F00036/RED](#). Vendimi për Konfirmimin u ndryshua më vonë, por ndryshimet nuk vlenin për z. Smakaj; shih KSC-BC-2023-12, F00260, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision Amending the "Decision on the Confirmation of the Indictment" and Setting a Date for the Submission of Preliminary Motions](#) (Vendim për Ndryshimin e Vendimit mbi Konfirmim e Aktakuzës dhe Caktimin e Datës për Dorëzimin e Mocioneve Paraprake), 14 prill 2025, publik.

⁵ KSC-BC-2023-12, Transkripti i seancës, *Paraqitja e Parë e Bashkim Smakajt* ("Transkripti i Paraqitjes së Parë"), 8 dhjetor 2024, publik, f. 40, rreshti 23, deri në f. 43, rreshti 25.

3. Më 7 shkurt 2025,⁶ 7 prill 2025,⁷ 5 qershor 2025,⁸ dhe 5 gusht 2025, (Vendimi i Katërt për Paraburgimin"),⁹ Gjykatësja e Procedurës Paraprake urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të z. Smakaj.

4. Më 8 shtator 2025, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") dorëzoi parashtrime mbi rishikimin e rregullt të paraburgimit të z. Smakaj ("Parashtrimet e ZPS-së").¹⁰

5. Mbrojtja e z. Smakaj ("Mbrojtja e Smakajt") nuk u përgjigj ndaj Parashtrimeve të ZPS-së.

II. PARASHTRIMET

6. ZPS-ja parashtron se z. Smakaj duhet të vazhdojë të mbahet në paraburgim¹¹ sepse që nga vendimet e mëparshme nuk ka ndodhur asgjë që do të ndikonte në konstatimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake në Vendimin e Katërt për Paraburgimin.¹²

7. ZPS-ja parashtron se paraburgimi i z. Smakaj vazhdon të jetë i domosdoshëm, sepse Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka konstatuar në mënyrë të përsëritur se vazhdojnë të jenë të pranishëm dhe të qartë të gjitha

⁶ KSC-BC-2023-12, F00164, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on Review of Detention of Bashkim Smakaj](#) (Vendim mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt), ("Vendimi i Parë i Rishikimit"), 7 shkurt 2025, publik.

⁷ KSC-BC-2023-12, F00249, Gjykatësja e Procedurës Paraprake,, [Second Decision on Review of Detention of Bashkim Smakaj](#) (Vendimi i Dytë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt) ("Vendimi i Dytë i Rishikimit"), 7 prill 2025, publik.

⁸ KSC-BC-2023-12, F00326, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Third Decision on Review of Detention of Bashkim Smakaj](#) (Vendimi i Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt) ("Vendimi i Tretë i Rishikimit"), 5 qershor 2025, publik.

⁹ KSC-BC-2023-12, F00406, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Fourth Decision on Review of Detention of Bashkim Smakaj](#), (Vendimi i Katërt mbi Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt) 5 gusht 2025, publik.

¹⁰ KSC-BC-2023-12, F00439, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit të Bashkim Smakajt*, 8 shtator 2025, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 11 shtator 2025, F00439/RED).

¹¹ Parashtrimet e ZPS-së, para. 9.

¹² Parashtrimet e ZPS-së, para. 2, 4, 7.

rreziqet e artikulueshme sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit në lidhje me z. Smakaj në këtë fazë.¹³ Në veçanti, ZPS-ja parashtron se: (i) atmosfera e përgjithshme e frikësimit të dëshmitarëve dhe viktimave në Kosovë vijon të jetë faktor relevant që duhet të merret parasysh, sidomos në kontekst të proceseve penale kundër ish anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("UÇK"); dhe (ii) rreziku që z. Smakaj të ushtrojë presion mbi dëshmitarët "vijon të jetë veçanërisht i lartë", sikurse ka konstatuar Gjykatësja e Procedurës Paraprake më parë.¹⁴

8. Gjithashtu, sipas ZPS-së, asnjë kusht i mundshëm i lirimit nuk mjafton për të zvogëluar mjaftueshëm rreziqet që lidhen me z. Smakaj, të cilat mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS").¹⁵

9. Së fundi, ZPS-ja parashtron se vazhdimi i paraburgimit është proporcional duke pasur parasysh se: (i) kundër tij janë ngritur dy akuza për vepra penale sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe mund të dënohet me burgim të gjatë në qoftë se shpallet fajtor; (ii) ai vazhdon të njihet gjithnjë e më shumë me provat kundër tij si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre; dhe (iii) procesi vijon me ritëm të shpejtë.¹⁶ ZPS-ja evidenton si tregues për ecurinë e shpejtë të procesit zhvillimet në vijim: (i) Dosja Gjyqësore Paraprake, Lista e Dëshmitarëve dhe Lista e Provave Materiale të ZPS-së u caktuan të dorëzohen më 19 shtator 2025, ndërsa Dosjet Gjyqësore Paraprake të Mbrojtjes - më 20 tetor 2025, çka pasqyron arritje të konsiderueshme në fazën paraprake; (ii) vazhdojnë të kryhen hapat hetimorë të tjerë; (iii) rezultatet nga kontrollimi i telefonave të sekuestruar i janë dhënë dhe i jepen të akuzuarit në mënyrë të vazhdueshme; (iv) ZPS-ja dorëzoi njoftimin e katërt sipas rregullës 102(3) të Rregullores dhe nxori materialin e kërkuar për të gjithë të akuzuarit; dhe (v) janë dorëzuar apelet që burojnë nga

¹³ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁴ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁵ Parashtrimet e ZPS-së, para. 5.

¹⁶ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

mocionet paraprake dhe aktualisht pritet të merren vendime në lidhje me to nga Gjykata e Apelit.¹⁷

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

10. Sipas nenit 41(6) të Ligjit, DHS-ja urdhëron arrestimin dhe paraburgimin e një personi vetëm kur: (a) ekziston dyshimi i bazuar se personi ka kryer një vepër penale që përfshihet në juridiksionin e DHS-së; dhe (b) ekzistojnë arsye të artikulueshme për të besuar se personi: (i) mund të arratiset; (ii) do të asgjësojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë provat e një veprë penale, ose do të pengojë ecurinë e procesit penal përmes ushtrimit të ndikimit mbi dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryerësit; ose (iii) do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një vepër penale të tentuar, ose do të kryejë një vepër penale që ka kërcënuar se do ta kryejë.

11. Sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, deri në kohën kur aktgjykimi të marrë formë të prerë ose deri në lirimin nga paraburgimi, me kalimin e dy (2) muajve nga vendimi i fundit për paraburgimin, Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose paneli i ngarkuar me çështjen, shqyrton nëse ekzistojnë ende arsyet për mbajtje në paraburgim dhe nxjerr vendim për vazhdimin ose ndërprerjen e paraburgimit.

12. Sipas nenit 41(12) të Ligjit, krahas masës së paraburgimit, për të siguruar praninë e të akuzuarit, përfshirë nëpërmjet videokonferencës, për të parandaluar përsëritjen e veprës penale, ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedurës penale, nga DHS-ja mund të urdhërohen masat në vijim: fletëthirrja, arrestimi, dorëzania, arresti shtëpiak, premtimi për të mos u larguar nga vendbanimi, ndalimi për t'iu afruar vendeve apo personave të caktuar, paraqitja në stacion të policisë apo në ndonjë vend tjetër dhe masa alternative shmangëse. Sipas rregullës 56(5) të Rregullores, Paneli mund t'i verë

¹⁷ Parashtrimet e ZPS-së, para. 6.

këto kushte për lirim si t'i shohë të përshtatshme për të siguruar praninë e personit të paraburgosur.

13. Sipas rregullës 56(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron që personi të mos mbahet në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme para hapjes së çështjes dhe, në rast të ndonjë vonese të paarsyeshme të shkaktuar nga Prokurori i Specializuar, pasi ka dëgjuar palët, paneli mund ta lirojë personin me kushte që i gjykon të përshtatshme.

IV. DISKUTIM

A. STANDARDI I ZBATUESHËM

14. Standardi i përdorur për rishikimin e paraburgimit është shtjelluar gjerësisht në vendimet e mëparshme dhe përfshihet këtu për referim.¹⁸ Rrjedhimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake do të zbatojë këtë standard në këtë vendim.

B. DYSHIMI I BAZUAR

15. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se në Vendimin e Konfirmimit ajo konstatoi se sipas nenit 39(2) të Ligjit, ekziston dyshimi i bazuar mirë se z. Smakaj është penalisht përgjegjës për vepra penale që përfshihen në juridiksionin e DHS-së, konkretisht tentativë për të penguar persona zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare brenda kuptimit, përkatësisht, të neneve 401(2) dhe (5), dhe 393 të Kodit Penal të Kosovës të vitit 2019, Kodi nr. 06/L-074, në shkelje të nenit 15(2) të Ligjit.¹⁹ Këto konstatime u bënë mbi bazën e një standardi më të lartë se ai i dyshimit “të bazuar mirë”, standard që tejkalon dyshimin e bazuar

¹⁸ Shih [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë për Paraburgimin, para. 20-21 (kushtet e përgjithshme), 22 (dyshimi i bazuar), 26-29 (domosdoshmëria e paraburgimit), 40 (lirimi me kusht) dhe 43 (proporcionaliteti), me referencat e cituara aty; dhe [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë për Paraburgimin, para. 18-19 (kushtet e përgjithshme), 20 (dyshimi i bazuar), 24- 27 (domosdoshmëria e paraburgimit), 41 (lirimi me kusht) dhe 46 (proporcionaliteti), me referencat a cituara aty.

¹⁹ [Confirmation Decision](#) (Vendimi i Konfirmimit), para. 313(c).

që kërkohet sipas sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.²⁰ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vëren se, deri më sot, në këtë çështje gjyqësore nuk ka pasur zhvillime që do t'i shfuqizonin këto konstatime.

16. Duke pasur parasysh sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni apo zhvillimi që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se vazhdon të ekzistojë dyshimi i bazuar se z. Smakaj ka kryer vepra penale të përfshira në juridiksionin lëndor të DHS-së, sipas nenit 41(6)(a) të Ligjit.²¹

C. DOMOSDOSHMEËRIA E PARABURGIMIT

1. Rreziku i arratisjes

17. Sa i përket rrezikut të arratisjes sipas nenit 41(6)(b)(i) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton së pari se të gjitha aspektet e shtjelluara në Vendimin e Dytë të Rishikimit janë relevante ende, konkretisht: (i) dijenia e z. Smakaj për akuzat e rënda kundër tij së bashku me dënimin e mundshëm që mund të marrë në qoftë se shpallet fajtor, që i japin motivin për t'iu shmangur drejtësisë;²² ii) mospërfillja e hapur që ka treguar ndaj ligjeve dhe rregulloreve

²⁰ Shih [Confirmation Decision](#), para. 42-43; dhe gjithashtu [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestimin), para. 43. Shih ngjashëm KSC-BC-2020-04, F00224/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shalë](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 22 qershor 2022, public, para. 24; dhe F00075/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, [Public Redacted Version of Decision on Review of Detention of Pjetër Shalë](#), (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Rishikimin e Paraburgimit të Pjetër Shalës), 10 shtator 2021, public, para. 22.

²¹ Shih ngjashëm, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 27; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 22; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 25; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 23; Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 42, rreshtat 20-24; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 43.

²² Shih, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 24; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 28; Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 42, rreshtat 3-7; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 69, me referencat e cituara aty.

të DHS-së;²³ (iii) fakti që ai ka pasaportë të vlefshme shqiptare dhe do të kishte mundësinë të arratisë duke udhëtuar lirisht në juridiksione ku nuk mund të kapet nga DHS-ja;²⁴ dhe (iv) fakti që i ka mjetet për t'i ikur drejtësisë, duke pasur parasysh pozitat (e larta) në të kaluarën të të akuzuarit në institucionet e Kosovës dhe lidhjet me ish-komandantë të UÇK-së.²⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur gjithashtu se i akuzuari mund të mbështetet ende në një rrjet të fuqishëm njerëzish me ndikim prej të cilëve mund të kërkojë dhe sigurojë mjete dhe ndihmë për t'u arratisur.²⁶ Gjykatësja e Procedurës Paraprake mban parasysh po ashtu faktin se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, z. Smakaj ka më shumë njohuri për provat mbi të cilat bazohen akuzat si rezultat i procesit të nxjerrjes në vijimësi të tyre.²⁷

18. Pasi ka shqyrtuar të gjitha aspektet e lartpërmendura në tërësi,²⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e mendimit se faktorët në favor të z. Smakaj - konkretisht karakteri dhe reputacioni pozitiv që ka ai, si dhe lidhjet e

²³ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 24; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 69.

²⁴ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 24; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 70.

²⁵ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 24; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 71.

²⁶ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 24; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 28; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 71.

²⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, ZPS-ja ka nxjerrë material shtesë sipas rregullës 102(1)(b). *Shih* Paketat 59, 61, 64, 68, 70, 71, 74, 76 të materialeve të nxjerra.

²⁸ Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje gjithashtu se Mbrojtja e Smakajt nuk dorëzoi parashtrime të cilat ajo mund t'i kishte marrë parasysh për të vlerësuar rrezikun e arratisjes në lidhje me z. Smakaj.

forta me familje, komunitet dhe lidhjet profesionale në Kosovë nuk zvogëlojnë mjaftueshëm rrezikun se ai do të arratiset.²⁹

19. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që tregon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Smakaj të arratiset.

2. Rreziku i pengimit të ecursisë së procesit të DHS-së

20. Sa i takon rrezikut të pengimit të procesit sipas nenit 41(6)(b)(ii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se konstatimet e bëra në Vendimin e Katërt të Rishikimit janë ende të vlefshme, përkatësisht: (i) lloji i akuzave të konfirmuara kundër z. Smakaj i cili ka qenë pjesëtar i një grupi të drejtuar nga z. Thaçi, që synonte të ndikonte paligjshëm ndaj dëshmitarëve;³⁰ (ii) këmbëngulja e z. Smakaj në përpjekjet për pengimin e procesit të DHS-së, ndër të tjera përmes zbatimit të urdhrave të personave me ndikim politik, si z. Thaçi, të cilëve ai u qëndron besnik;³¹ (iii) z. Smakaj po njihet gjithmonë e më shumë me provat inkriminuese kundër tij në këtë çështje, si pasojë e nxjerrjes së vazhdueshme të materialit,³² çka krijon motiv të mëtijshëm për të ndërhyrë ndaj dëshmitarëve.³³ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se nuk është e nevojshme që rreziku i pengimit të materializohet përmes

²⁹ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 29; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 23, 25; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 30; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 30; Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 42, rreshtat 7-9; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 72.

³⁰ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 27; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 32; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 74, me shpjegime të mëtejshme.

³¹ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 27; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 33; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 32; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 74.

³² *Shih më lart* poshtëshënimin 27.

³³ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 27; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 34; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 33; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 75.

kontaktit personal të z. Smakaj me dëshmitarë, por mund të materializohet për shembull përmes bashkërendimit të mëtejshëm me njerëz që janë besnikë ndaj komandantëve të UÇK, si për shembull z. Thaçi, dhe/ose njerëz nga qarqet politike të tij.³⁴

21. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton gjithashtu se rreziku i pengimit nuk ka pushuar së ekzistuari me përfundimin e paraqitjes së provave nga ZPS-ja në çështjen *Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit dhe të tjerëve* ("Çështja 06"), sepse procesi ende nuk ka përfunduar dhe (i) një Trup Gjykues mund, në rrethana të jashtëzakonshme, të dëgjojë prova shtesë pas mbylljes së paraqitjes së provave sipas rregullës 136 të Rregullores dhe (ii) ndaj dëshmitarëve që tashmë kanë dhënë dëshmi mund të ketë veprime hakmarrjeje ose mund të nxiten të tërheqin dëshmitë e tyre.³⁵ Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton më tej se rreziku i pengimit nuk vlerësohet vetëm në raport me Çështjen 06, por edhe në raport me këtë çështje gjyqësore.³⁶ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, ZPS-ja ka dorëzuar listën e dëshmitarëve të vet.³⁷

³⁴ *Shih*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 29; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 34, me referencat e cituara aty.

³⁵ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 28. *Shih* KSC-BC-2023-12, IA004/F00005, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Isni Kilaj's Appeal Against Third Decision on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Isni Kilajt kundër Vendimit të Tretë mbi Rishikimin e Paraburgimit), ("Vendimi mbi Apelin e Kilajt"), 1 shtator 2025, publik, para. 74 dhe referencat aty. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, IA033/F00006, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Decision on Rexhep Selimi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Vendim mbi Apelin e Rexhep Selimit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 54; IA035/F00005/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Jakup Krasniqi's Appeal Against Consolidated Decision on Request for Provisional Release and on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Jakup Krasniqit kundër Vendimit Përmbledhës mbi Kërkesën për Lirim të Përkohshëm dhe mbi Rishikimin e Paraburgimit), 13 gusht 2025, publik, para. 34.

³⁶ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 31.

³⁷ KSC-BC-2023-12, F00459/A03, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe të Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, konfidenciale. ZPS-ja dorëzoi përsëri listën e dëshmitarëve, pas dorëzimit të versionit të korrigjuar të Dosjes Gjyqësore Paraprake (shih F00467/A03, Prokurorja e Specializuar, *Shtojca 3 e Parashtrimit prej Prokurorisë të Dosjes Gjyqësore Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe të Listës së Provave Materiale*, 26 shtator 2025, konfidenciale)

Megjithëse Gjykatësja e Procedurës Paraprake është e mendimit se rreziku i ndërhyrjes ndaj dëshmitarëve është i ulët, kjo nuk zhvlerëson konstatimin e saj në Vendimin e Katërt të Rishikimit se vazhdon të ekzistojë rreziku i pengimit të procesit duke pasur parasysh të gjithë faktorët e tjerë në të cilët u bazua ajo.

22. Së fundi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se ajo ende i vlerëson aspektet dhe faktorët e mësipërm në kontekstin e atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.³⁸ Në këtë kontekst, rreziku që z. Smakaj të ushtrojë presion mbi dëshmitarët është veçanërisht i lartë, duke pasur parasysh lidhjet e tij³⁹ që përmenden më lart.⁴⁰

23. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Smakaj të pengojë ecurinë e proceseve të DHS-së.

3. Rreziku i kryerjes së krimeve të tjera

24. Sa i takon rrezikut të kryerjes së veprave penale të tjera sipas nenit 41(6)(b)(iii) të Ligjit, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se, edhe pse ekzistenca e rrezikut të pengimit të procesit nuk nënkupton automatikisht rrezikun e kryerjes së veprave penale të tjera, në këto rrethana, faktorët mbi të cilët mbështetet rreziku i parë janë me rëndësi edhe për vlerësimin e këtij të fundit.⁴¹ Në lidhje me këtë, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vë në dukje se, sa

³⁸ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 32; [Third Review Decision](#) (Vendimi Tretë i Rishikimit), para. 30; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 35; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 34; [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 76, me referenca të cituara aty. Shih gjithashtu [Decision on Kilaj Appeal](#) (Vendimin mbi Apelin e Kilajt), para. 83.

³⁹ Shih, [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 32; [Third Review Decision](#) (Vendimi Tretë i Rishikimit), para. 30; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 35, me referencat e cituara aty.

⁴⁰ Shih më lart, para. 17, 20.

⁴¹ Shih [Decision on Arrest](#) (Vendimi për Arrestim), para. 78.

i takon rrezikut të pengimit të procesit, faktorët relevantë që duhet të merren parasysh janë të njëjtë me ata të përshkruar në paragrafët e mësipërm 20-22. Në veçanti, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se, duke qenë se i akuzuari (pretendohet se) tentoi të pengonte procesin në dobi të z. Thaçi, nuk mund të përjashtohet mundësia që ai t'i përsërisë këto veprime në dobi të vetvetes, veçanërisht në kontekst të atmosferës së përgjithshme të frikës dhe frikësimit në Kosovë kundër dëshmitarëve aktualë dhe të mundshëm të DHS-së.⁴² Pasi ka ekzaminuar këta faktorë nga fillimi, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur se ende ekziston rreziku që z. Smakaj të përsërit veprat penale që pretendohet se ka kryer, përfshirë në lidhje me dëshmitarë të cilët kanë dhënë ose mund të japin dëshmi në gjykimin *Thaçi dhe të tjerët* dhe/ose në çështjen aktuale.⁴³

25. Bazuar në sa më lart dhe në mungesë të ndonjë informacioni të ri që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se vazhdon të ekzistojë rreziku që z. Smakaj të kryejë vepra penale të tjera.

4. Përfundim

26. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se ka arsye të artikulueshme për të besuar se z. Smakaj mund të arratiset, të pengojë ecurinë e procesit të DHS-së, dhe të kryejë vepra penale të tjera, çka e bën të domosdoshëm vazhdimin e paraburgimit të z. Smakaj në përputhje me nenin 41(6)(b) të Ligjit. Gjykatësja e Procedurës Paraprake më poshtë do të vlerësojë nëse këto rreziqe mund të zvogëlohen mjaftueshëm me ndonjë prej kushteve për lirimin e z. Smakaj.

⁴² *Shih më lart* para. 22; *shih ngjashëm*, [Fourth Review Decision](#) (Vendimin e Katërt të Rishikimit), para. 34; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 32; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 37; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 37.

⁴³ *Shih më lart* para. 21; dhe *gjithashtu* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt të Rishikimit), para. 34; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 28, 32, me referencat e cituara aty.

D. LIRIMI ME KUSHT

27. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton konstatimin e mëparshëm se asnjë prej kushteve të propozuara nga Mbrojtja e Smakajt, dhe askushte të tjera të vendosura *proprio motu*,⁴⁴ nuk do të zvogëlonin mjaftueshëm rreziqet ekzistuese, veçanërisht rreziqet e pengimit të ecurisë së procesit të DHS-së dhe të kryerjes së veprave penale të tjera, duke marrë parasysh lidhjet e konsiderueshme të tij me persona me ndikim në rrjetin dhe/ose qarqet politike të UÇK-së.⁴⁵

28. Pasi nuk ka marrë informacion që provon të kundërtën, Gjykatësja e Procedurës Paraprake vazhdon të jetë e bindur se këto kushte: (i) nuk trajtojnë mundësinë që z. Smakaj të përdorë pajisje komunikimi që u përkasin personave të tjerë ose t'u kërkojë të tjerëve të përdorin mjetet e tyre të komunikimit për këtë qëllim; dhe (ii) nuk mund të garantojnë monitorimin efektiv të komunikimeve të z. Smakaj.⁴⁶ Gjithashtu sipas Gjykatësës së Procedurës Paraprake: (i) megjithëse rreziku i mesazheve dhe udhëzimeve të paligjshme nuk mund të eliminohet plotësisht, masat në fuqi në objektin e paraburgimit të DHS-së, të marra në tërësi, ofrojnë garanci të forta kundër vizitave dhe komunikimeve të pamonitoruara me anëtarë të familjes dhe vizitorë të miratuar paraprakisht, për zvogëlimin sa më shumë që të jetë e mundur të rrezikut të

⁴⁴ *Shih ngjashm* KSC-BC-2020-06, IA017/F00011/RED, Paneli i Gjykatës së Apelit, [Public Redacted Version of Decision on Hashim Thaçi's Appeal Against Decision on Review of Detention](#) (Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Apelin e Hashim Thaçit kundër Vendimit në lidhje me Rishikimin e Paraburgimit), 5 prill 2022, publik, para. 51.

⁴⁵ *Shih* [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 37-39; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 35-37; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 41-42; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 43-45; Transkriptin e Paraqitjes së Parë, f. 37, rreshti 24, deri në f. 38, rreshti 6; f. 43, rreshtat 3-5.

⁴⁶ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 38; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 36; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 41; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 43.

pengimit të procesit dhe të kryerjes së veprave penale të tjera;⁴⁷ dhe (ii) Administratorja dhe paneli, që kanë qasje të pakufizuar në informacionin konfidencial lidhur me dëshmitarët dhe viktimat, mund të ndërmarrin veprime më shpejt se autoritetet e tjera që veprojnë sipas një kornize të ndryshme.⁴⁸

29. Bazuar në sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake arrin në përfundimin se kushtet për lirim të z. Smakaj, përfshirë kushtet e propozuara (më parë) nga Mbrojtja e Smakajt, ose kushte të tjera të arsyeshme të vendosura nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake janë të pamjaftueshme për të zvogëluar në mënyrë të duhur rreziqet sipas nenit 41(6)(b)(i)-(iii) të Ligjit.

E. PROPORCIONALITETI I PARABURGIMIT

30. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton se: (i) z. Smakaj ndodhet në paraburgim që nga arrestimi i tij më 5 dhjetor 2024;⁴⁹ (ii) ndaj tij është ngritur një akuzë për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe një akuzë për mosbindje ndaj gjykatës, për të cilat ai mund të dënohet, përkatësisht, me deri në pesë (5) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim;⁵⁰ dhe (iii) rreziqet sipas nenit 41(6)(b) të Ligjit (në veçanti, rreziqet e pengimit të procesit dhe kryerjes së veprave penale të tjera) nuk mund të zvogëlohen me asnjë nga kushtet e propozuara ose shtesë.⁵¹

31. Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu merr parasysh se, që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit: (i) ZPS-ja ka dorëzuar Dosjen Paraprake dhe listat

⁴⁷ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 38; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 36; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 41; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 43, me referencat e cituara aty.

⁴⁸ [Fourth Review Decision](#) (Vendimi i Katërt i Rishikimit), para. 38; [Third Review Decision](#) (Vendimi i Tretë i Rishikimit), para. 36; [Second Review Decision](#) (Vendimi i Dytë i Rishikimit), para. 41; [First Review Decision](#) (Vendimi i Parë i Rishikimit), para. 43, me referencat e cituara aty.

⁴⁹ Shih më lart, para. 1

⁵⁰ Shih KSC-BC-2023-12, F00264/A02, Prokurorja e Specializuar, [Public Redacted Amended Confirmed Indictment](#) (Version i Redakuar Publik i Aktakuzës së Konfirmuar të Ndryshuar , 16 prill 2025, publik, para. 47.

⁵¹ Shih më lart, para. 27-29.

e dëshmitarëve dhe të provave materiale më 19 shtator 2025;⁵² (ii) ZPS-ja ka vijuar të nxjerrë materialin sipas rregullës 102(1)(b)⁵³ dhe 103 të Rregullores;⁵⁴ (iii) ZPS-ja ka dorëzuar njoftimin e saj të katërt sipas rregullës 102(3) të Rregullores⁵⁵ dhe, siç kërkonte Mbrojta, ka nxjerrë një numër materiale; ⁵⁶ (iv) ZPS-ja i ka paraqitur Gjykatësës së Procedurës Paraprake pikat për të cilat pajtohen palët, sikurse parasheh rregulla 95(3) e Rregullores;⁵⁷ (v) kryerja e hapave hetimorë të mbetur të ZPS-së vijon në mënyrë të rregullt⁵⁸ dhe materiali

⁵² KSC-BC-2023-12, F00459, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Paraprake, Listës së Dëshmitarëve dhe Listës së Provave Materiale*, 19 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 26 shtator 2025 (shih F000467, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim prej Prokurorisë i Dosjes Gjyqësore Paraprake të Korrigjuar*, 26 shtator 2025, publike, me Shtojcat 1-5, konfidenciale).

⁵³ Shih Paketat 9, 61, 64, 68, 70, 71, 74, 76 të materialit të nxjerrë. Shih gjithashtu, KSC-BC-2023-12, F00420, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrime të Prokurorisë sipas Urdhrit F00395* ("Parashtrimet e ZPS-së për Ecurinë"), 25 gusht 2025, konfidenciale, para. 2, 3. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 5 shtator 2025, F00420/RED. Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson kërkesën në proces shqyrtimi lidhur me nxjerrjen e mëtejshme të materialit sipas rregullës 102(1)(b) të Rregullores (shih KSC-BC-2023-12, F00458, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialeve sipas Rregullës 102(1)(b)*, 19 shtator 2025, konfidenciale; F00462, Prokurorja e Specializuar, *Sqarim në lidhje me Kërkesën e Prokurorisë për Nxjerrjen e Materialit sipas Rregullës 102(1)(b)*, F00458, 23 shtator 2025, konfidencial)

⁵⁴ Shih Paketën 60 të materialit të nxjerrë.

⁵⁵ KSC-BC-2023-12, F00417, Prokurorja e Specializuar, *Njoftimi i Katërt i Prokurorisë sipas Rregullës 102(3)*, 18 gusht 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁵⁶ Shih Paketat 58, 62, 63, 65, 66, 69, 75 të materialit të nxjerrë. Shih gjithashtu Parashtrimet e ZPS-së lidhur me Ecurinë, para. 17, 19.

⁵⁷ KSC-BC-2023-12, F00469, Prokurorja e Specializuar, *Njoftim në lidhje me Faktet e Pranuara*, 29 shtator 2025, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁵⁸ Shih KSC-BC-2023-12, F00407, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Urdhër (F00361) dhe Modalitetet e Mëtejshme për Ekzaminim nga Mbrojtësja e Pavarur* 5 gusht 2025, konfidencial; F00431, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Vazhdimin e Fazës 2 të Mekanizimit për Ekzaminimin e Materialit të Ruajtur dhe Çështje Përkatëse*, 29 gusht 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00432, Mbrojtësja e Pavarur, *Paraqitje e Rezultateve Paraprake nga Mbrojtësja e Pavarur*, 1 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale, dhe Shtojcat 2-5, rreptësisht konfidenciale dhe ex parte; F00433, Administratorja, *Parashtrim i Administratores i 130 Dokumenteve Rezultuese nga Termit e Kërkimit 2 dhe 3, sipas Vendimit F00431, dhe Kërkesë për Shtyrjen e Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriminalistikë Digjitale të Raportit lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave*, 3 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F00434, Mbrojtësja e Pavarur, *Përcjellje prej Mbrojtësës së Pavarur e Dokumenteve Rezultuese të Redaktuara sipas Vendimit F00431*, 5 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcat 1-11, konfidenciale; F00437, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Informacion të Mëtejshme nga EFC dhe Informacion nga Zyra Administrative*, 8 shtator 2025, konfidencial; F00442, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Shtyrje të Afatit për Dorëzimin prej Kompanisë për Kriminalistikë Digjitale të Raportit*

shtesë parashihet të nxirret pas përfundimit të këtyre hapave;⁵⁹ (vi) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka ftuar Mbrojtjen të dorëzojnë Dosjet Gjyqësore Paraprake të tyre dhe të njoftojnë ZPS-në nëse synojnë të përdorin arsye që përjashtojnë përgjegjësinë penale deri më 20 tetor 2025;⁶⁰ dhe (vii) Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka informuar Palët se ajo synon t'ia kalojë një trupi gjykues çështjen në gjysmën e parë të nëntorit 2025, në qoftë se vendimet mbi apelet në lidhje me mocionet paraprake që do të jepen nga Paneli i Gjykatës së Apelit lejojnë këtë transferim.⁶¹ Rrjedhimisht, sipas mendimit të Gjykatës së Procedurës Paraprake, procesi vijon me ritëm të shpejtë, çka bën që çështja të jetë afër kalimit të saj trupit gjykues.

32. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka vlerësuar në mënyrë të duhur kohën shtesë që z. Smakaj ka kaluar në paraburgim që nga Vendimi i Katërt i Rishikimit, por konstaton se – kur krahasohet me faktorë të tjerë të përshkruar në paragrafët 30-31 më lart – paraburgimi i tij mbetet proporcional.

33. Gjithashtu, sipas nenit 41(10) të Ligjit dhe rregullës 57(2) të Rregullores, paraburgimi i z. Smakaj do të rishikohet në mënyrë të rregullt pasi të kenë kaluar dy (2) muaj nga vendimi i fundit në lidhje me paraburgimin ose në çdo kohë, në bazë të një kërkesë apo *proprio motu*, kur ka ndryshime të rrethanave që nga rishikimi i fundit.

lidhur me Interpretimin e Meta të Dhënave, 9 shtator 2025, konfidencial ; F00471, Administratorja, *Parashtrim i Raportit të Kompanisë për Kriminalistikë Digjitale sipas Vendimit F00431*, 30 shtator 2025, konfidencial, me Shtojcën 1, konfidenciale; F00472, Administratorja, *Raporti i Tretë Mujor i Administatorës sipas Vendimit F00350*, 30 shtator 2025, konfidencial.

⁵⁹ *Shih* KSC-BC-2023-12, F00368, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Qasje në Material dhe Çështje Përkatëse*, 9 korrik, 2025, konfidencial, para. 53, 57(i), me Shtojcën 1, konfidenciale.

⁶⁰ KSC-BC-2023-12, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, [Decision on the Remaining Calendar of the Pre-Trial Proceedings](#) (Vendim mbi Pjesën e Mbetur të Kalendarit të Fazës Paraprake) ("Vendimi për Kalendarin e Fazës Paraprake"), 16 shtator 2025, publik, para. 17-18.

⁶¹ [Pre-Trial Calendar Decision](#) (Vendimi për Kalendarin e Fazës Paraprake), para. 21 dhe 23(e).

34. Duke pasur parasysh sa më lart, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se z. Smakaj nuk është mbajtur në paraburgim për një periudhë të paarsyeshme brenda kuptimit të rregullës 56(2) të Rregullores.

V. VENDIM

35. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- a) URDHËRON vazhdimin e paraburgimit të z. Smakaj;
- b) URDHËRON z. Smakaj që, nëse dëshiron, të paraqesë parashtrime lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit deri të **martën, 11 nëntor 2025, në orën 16:00**, me përgjigjet dhe kundërpërgjigjet sipas afateve të përcaktuara në rregullën 76 të Rregullores;
- c) URDHËRON ZPS-në që, në qoftë se z. Smakaj vendos të mos paraqesë parashtrime deri në afatin e lartpërmendur, të paraqesë parashtrime në lidhje me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të z. Smakaj deri të **martën, 18 nëntor 2025, në orën 16:00**, dhe z. Smakaj që, nëse dëshiron, të dorëzojë përgjigjen e tij deri të **martën, 25 nëntor 2025, në orën 16:00**; dhe
- d) URDHËRON Zyrën Administrative të riklasifikojë Parashtrimet e ZPS-së (F00439) si publike deri të **mërkurën, 8 tetor 2025**.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marzhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E premtë, 3 tetor 2025

Në Hagë, Holandë.